2771
14.07.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARI
BASHKIA GRAMSH

RELACION TEKNIK

MBI GJENDJEN TEKNIKE DHE NEVOJËN E SISTEMIMIT TË RRUGËS AUTO HASAN KAMBER DERMYSHI BASHKIA GRAMSH.

Rruga Hasan Kamber Dermyshi ndodhet në grupin e banimit vendosur në pjerrësitë e kodrës në anën lindore të ish objektit '85' dhe shtrihet në kuotat 245-275 m m.n/d duke lidhur me rrugën kryesore rreth 30 banesa,të cilat nuk kanë akses për qarkullim normal në cdo kohë që ky komunitet ka nevojë.

Kjo rrugë ka një gjatësi prej rreth 150m dhe gjërësi mesatare prej rreth 3.5 deri 3.0m me një pjerrësi që shkon deri në 25 % dhe është e shtruar pjesërisht me zhavorr e pjesërisht me beton ku ujrat në kohë rreshjesh rrjedhin në mënyrë të pa kontrolluar duke mbushur me aluvione pjesën kaluese si dhe krijimin e situatave të pa këndëshme për qarkullimin e mjeteve e të komunitetit.

Rruga aktualisht është e kalueshme nga automjetet deri në 30m nga rruga kryesore dhe më pas kërkon zgjerim me gërmim e prishje edhe disa gardheve apo pak mure rrethuese duke i zëvëndësuar me mure betoni themel xokol e kunetë anësoree të nevojëshme për sistemimin e ujrave të bardha e si dhe plotësimin e gjërësisë së pjesës kaluese prej 3.5m..

Trasçja e kësaj rruge kalon nëpër një terren të thyer kodrinor malor duke filluar në kuotën rreth 245 m m.n.d. në perëndim dhe përfundon në rreth 275 m m.n.d. pika më e lartë ku në disa segmente ka pjerrësi deri në 25 %, ndërsa në sektorën fundor kërkohet të ndërtohet një mur mbajtës për krijimin e mundësisë së kthimit të automjeteve meqënëse këtij segmenti rrugor imungon dalja në anën e sipërme e cila mund të realizohet në të ardhmen për arsye të problemeve të pronësisë e fondeve të mëdha që nevoiten për ndërtimin e sajë

Në këtë rrugë qarkullojnë automjete të tipeve e tonazheve të ndryshme nga 1.5-20 ton të cilat përdoren nga komuniteti për kryerjen e shërbimeve të ndryshme social ekonomike dhe biznesit me subjekte të ndryshme shtetërore e private në Bashkinë Gramsh dhe më gjërë.

Ndër vite në këtë rrugë nuk janë bërë investime të mjaftueshme e të nevojëshme në mirmbajtjen e saj kryesisht ato më elementare si; mbushje gropash në shtresa zhavorri, ndërtim kanale anësore,apo shtrim tubacionesh dhe puscta për disiplinimin e ujrave sipërfaqësore.

Aktualisht ky segment rrugor është tepër i dëmtuar në të gjithë elementët përbërës të tij dhe i pa kalueshëm në cdo ditë të vitit sidomos në kohë me rreshje për shkak të terrenit të thyer kodrinlor,mungesës së kanalevc anësore ,shtresës së betont etje

Problematik është bërë qarkullimi në këtë segment rrugor edhe për shkak se nëpër këtë rrugë lëvizin edhe mjaft banorë me aftësi të kufizuara sepse nuk ka trotuare dhe se ato mund të ndërtohen vetëm në 20 metrat e para të rrugës.

.Në këto kushte kjo rrugë kërkon ndërhyrje emergjente për meremetimin e sajë,për garantimin e qarkullimit normal të komunitetit e automjeteve në cdo kohë dhe për më tepër sepse ka kërkesa për ndërtime e rikonstruksione në banesa e të pronave ekzistuese.

Për realizimin e këtij objekti konkretisht problemet paraqiten si më poshtë :

A-Shtresat e Rrugës

- Rruga në tërë gjatësinë e saj është me shtresa zhavori të dëmtuar me gropëzime me sipërfaqe 2-4 m² e thellësi 20- 30 cm shkaktuar nga ujrat që rrjedhin në rrugë
- Kanalet anësore mungojnë e duhet të realizohen tip kunete e hapur betoni..
- Në fillim të rrugës në rreth 20m gjatësi duhet të realizohen trotuare me pllaka betoni.

B- Veprat e artit

Rruga në pjesën fundore sipër ka nevojë për ndërtim rreth 20ml mure mbajtëse me qëllim krijimin sheshi për kthimin makinash meqënëse rruga nuk ka dalje në anën tjetër.

Ky investim do të përmirësojë ndjeshëm infrastrukturën rrugore lidhëse ndërmjet këtij grupi banimi me pjesët e tjera të qytetit të Gramshit.

Punimet e rikonstruksionit do të bëhen në pjesë të vecanta të përshkruara në projekt,por sipas gjurmës aktuale deri tek dy degëzimet ekzistuese me gjatësi 0.12 km me gjërësia të rrugës së shtruar prej 3 – 3.5m dhe një kunetë anësore për disiplinimin e ujrave të shiut..

Duke patur parasysh pjesët e rrugës ku do të ndërhyet është e nevojëshme të kryhen volume punc për disa procese kryesore si më poshtë:

Gërmimc e levizje dherassh	rreth	250 m3
Ndërtim mure mbajtëse prej betoni	rreth	83 m3
Shtresa zhavorr lumili 10 cm	rreth	450 m2
Shtresë betoni në rrugë 10 cm	rreth	77 m3
Hekur betoni	rreth	3.5 ton
Trotuare me pllaka betoni	rreth	60 m2 etje.

Me realizimin e këtij investimi do të përmirësohen edhc më tepër kushtet e qarkullimit në rrugë, kushtet higjeno sanitare e sistemimi mjedisit përreth duke e kthyer në normalitet lëvizjen e sigurtë të automjeteve e të komuniteti të kësaj zone.

HARTUESI :

Ing.Dhori Nishku